Republika e Kosovës

Komuna e Istogut

KONTRATË PËR PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT-Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson menaxher-i Gëzim Ademaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

"INFINIT" SHPK nga Prishtina, të cilën e përfaqëson z. Astrit Uka, ne cilësinë e drejtorit të ndërmarrjës me nr. te Rexh. Biznesit 810860818 (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

FURNIZIMI ME PAISJE MBROJTESE MASKA, DOREZA DHE DEZINFEKTUES

Nr. I prokurimit	**633-20-7118 -1-3-6/**
Nr. I brendshëm	**633 / 020 / 116/ 136**

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë:

FURNIZIMI ME PAISJE MBROJTESE MASKA, DOREZA DHE DEZINFEKTUES

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 10. DITË pas porosisë se Autoritetit Kontraktues. nga dita e nënshkrimit të kontratës dhe të lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jenë AUTORITETI KONTRAKTUES NE ISTOG

2.3 Inkotermi1 i zbatueshëm do të jetët *DDP*

Neni 3 Origjina

3.1Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjën e kontratës.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet total I kësajë kontrate për pagesë është: **1.389,00 €**

"Njëmijëetreçindetetëdhjetetëdhjetëenëntëeuro"

4.2. Ky është çmimi i vetenm dhe i pandryshuar qe Autriteti Kontraktues i ka borgj kontraktorit.

4.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5. Kohëzgjatja e kontratës:

5.1. Te gjitha furnizimet sipas kësajë kontrate do të fillojnë menjeherë pas nenshkrimit te sajë dhe do të përfundojnë me datë: 15. 12. 2020

Neni 6. Ndërprerja e kontratës:

6.1 Kjo kontratë mund të shkëputet kurdo që kontraktori nuk i respekton kushtet e përgjithshme dhe te veqanta te kontratës te parapara ne dosjen e tenderit, dhe kur per një gje te tillë plotesohen këto kushte, duke pas parasysh edhe sanksionet e parapara per dëmet qe eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues.

Neni 7 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

7.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Kjo marrëveshje e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare;

Plani per menaxhimin e kontratës

7.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 8 **Komunikimet**

8.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht

8.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

8.3 Kurdo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe **fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose"vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.**

8.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues: **Komuna e Istogut**		***Për Kontraktorin:*** **"INFINIT" Shpk**	
Emri:	***Gëzim Ademaj***	***Emri:***	***Astrit Uka***
Pozita:	***Menaxher-i i Prokurimit***	***Pozita:***	***D r e j t o r***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	09. 12. 2020	***Data:***	09.12.2020
Vula		***Vula***	

	KOMUNA ISTOG				
Nr	**Pershkrimi**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi per njesi**	**Totali**
	Emri i Artikullit(Përshkrimi)				
1	MASKA MBROJTESE (SHUME PERDORIMESH) (KN95 me filter, me mbajtëse elastike pas veshëve dhe pjesë metalike për adaptim mbi hundë)	COPE	**1000**	**0.75**	**750.00**
2	MASKA NJE PERDORIMSHE ME LASTIK (Maska mbrojtëse tri shtresore, për një përdorim, me mbajtëse elastike pas veshëve dhe pjesë metalike për adaptim mbi hundë. Paketimi 50copë)	pako	**20**	**4.50**	**90.00**
3	DOREZA NJE PERDORIMSHE (Dorëza LATEX, një përdorimshe, pa pudër, madhësia M dhe L, paketimi 100 copë)	pako	**20**	**11.50**	**230.00**
4	DEZINFEKTUES 250ML	COPE	**200**	**1.00**	**200.00**
5	DEZINFEKTUES 500ML	COPE	**70**	**1.70**	**119.00**
	T O T A L I ME TE GJITHA NGARKESAT				**€ 1,389.00**
Përshkrimi i çmimeve -furnizimet duhet te permbajne keto specifikime					